



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT  
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA



**RREGULLORE**

Nr. 01, datë 06.01.2012

**PËR**

**PROCEDURAT E KONSTATIMIT DHE SHQYRTIMIT TE KUNDËRVAJTJEVE  
ADMINISTRATIVE, DHE MARRJEN E VENDIMIT PËR DËNIMIN E KUNDËRVAJTJEVE  
ADMINISTRATIVE NE SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT DHE  
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kudrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010, për “Kundërvajtjet administrative” dhe Kodit të Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë;

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për mënyrën e procedimit në konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, si dhe vendosja e masave administrative në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

## **Neni 2 Autoriteti**

Kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes administrative në sektorin të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura i takon institucionit të ERRU-së, përgjegjës për zbatimin e ligjit nr.8102.

Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU është autoriteti që ka të drejtën e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative dhe të nxjerrjes së vendimit përkatës që vendos dënime administrative për subjektet që operojnë në sektorin të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, në rastet e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative sipas ligji 8102.

ERRU, nëpërmjet strukturave të veta, ndjek zbatimin e vendimit për kundërvajtjen administrative dhe ekzekutimin e tij, sipas legjislacionit në fuqi, në bashkëpunim me organet e tjera shtetërore/private, dhe organet gjyqësore.

## **Neni 3 Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

“Ent Rregullator (ERRU) është institucioni i rregullimit të sektorit të furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura;

“Komisioni” do të kuptohet si Komisioni Kombëtar i Rregullimit që udhëheq Entin Rregullator;

“Subjekt” është çdo person fizik apo juridik, privat apo publik që merret me veprimtarinë e grumbullimit, të shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik;

“Inspektim” është çdo formë kontrolli që ERRU kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore e akteve rregullatore nga subjekti i inspektimit;

“Grup inspektimi” është ekipi i ERRU që perbehet nga te pakten dy persona, të autorizuar rast pas rasti nga Kryetari, me qëllim ushtrimin e inspektimeve;

“Subjekti i inspektimit” është çdo subjekt që operon në sistemet ujeshjelle kanalizime;

“Kundërvajtje administrative” është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji 8102 parashikon një dënim administrativ;

“Dënim administrativ” është masa e gjobës e parashikuar nga ligji 8102;

#### **Neni 4**

##### **Grupi i inspektimit**

Grupi i inspektimit, ngrihet rast pas rasti, me urdhër të Kryetarit të ERRU-së. Në këtë urdhër përcaktohet programi i kontrollit, objekti i kontrollit, dhe koha e kryerjes së tij. Një kopje e këtij urdhëri i dorëzohet subjektit në momentin e fillimit të inspektimit.

Grupi i inspektimit, gjatë ushtrimit të inspektimit, mban të ekspozuar dokumentin personal të lëshuar nga ERRU, me vulë të institucionit dhe i firmosur nga titullari.

Grupi i inspektimit gjatë ushtrimit të inspektimit pranë subjektit, ka të drejtë të verifikojë çfarëdo fakti, kushti, praktikë apo çështje, të cilën ai e konsideron të nevojshme për të përmbushur objektin e inspektimit.

#### **Neni 5**

##### **Procesverbali**

Grupi i inspektimit, kur konstaton se është kryer një shkelje e ligjit 8102, rregullores së licencimit dhe vendimeve të tjera të ERRU, plotëson me shkrim procesverbalin sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregullore.

Ky procesverbal firmoset nga të dyja palët. Kundërshtimi për të firmosur këtë procesverbal, nga përfaqësuesi i subjektit, nuk e bën atë të pavlefshëm.

#### **Neni 6**

##### **Kundërvajtjet administrative**

Shkeljet dhe dënimet administrative janë përcaktuar në ligjin nr.8102 dhe janë si më poshtë:

- a. mospagimi i detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky Ent, dënohet me gjobë deri në shumën 100 000 lekë;
- b. moszbatimi i vendimeve të Entit Rregullator për tarifatat dënohet me gjobë deri në shumën 100 000 lekë;
- c. moszbatimi i kushteve të licencës dënohet me gjobë në shumën 50 000 lekë;
- d. ushtrimi i veprimtarisë pa licencë dënohet me gjobë në shumën 300 000 lekë.

## Neni 7

Përvec dënimeve administrative të parashikuara në ligjin 8102, Komisioni në rastet e konstatimit të shkeljes së kushteve të licences (Kapitulli III, Rregullorja e licencimit), ka të drejtë:

a) të pezullojë licencën e një subjekti kur:

- ai nuk i përgjigjet legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KKRRU
- ai shkel kushtet e licencës;
- nuk paraqitet brenda afatit të caktuar nga Komisioni për ndryshimin e kushteve të licencës.

b) të revokojë licencën kur:

- në veprimtarinë e subjektit konstaton shkelje të rënda të kushteve të licencës;

Këto dënime mund të jepen si dënime kryesore ose si dënime plotësuese të dënimit për kundërvajtjen administrative.

Në rastet e shkeljeve flagrante të kryera nga subjektet, nga të cilat janë shkaktuar pasoja të rënda në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, dhe/ose në furnizimin me ujë të popullatës, ERRU ka të drejtën ti drejtohet organeve kompetente për fillimin e procedimit penal për personat përgjegjës.

## Neni 8

Grupi inspektimit, pas konstatimit të shkeljeve të përmendura më sipër, brenda 5 ditëve pune i paraqet Komisionit një raport, i cili përmban informacion mbi shkeljet e konstatuara, duke përmbledhur arsyet ligjore dhe faktike për të cilat kërkohet vendim marrja e Komisionit.

## Neni 9

Komisioni Kombëtar Rregullator pas marrjes së raportit dhe shqyrtimit të materialit, përcakton datën për shqyrtimin e pretendimeve të personave të interesuar, datë e cila ju njoftohet atyre zyrtarisht.

Data e përcaktuar nga KKRR, i njoftohet personave të interesuar përpara jo më pak se 10 ditë pune, me qëllim që ata të kenë mundësi të përgatisin pretendimet e tyre dhe të paraqesin provat e tyre.

### Neni 9a

#### Procedura hetimore

Komisioni njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha mjetet dhe metodat e të provuarit të lejuara nga ligji dhe aktet nënligjore.

Në ushtrim të detyrave të veta, Komisioni ka të drejtë të kërkojë informacion për çfarëdo fakt, kusht, praktikë apo çështje, të cilën ai e konsideron të nevojshme për të përcaktuar nëse një person ka shkelur dispozitat e ligjit 8102, rregulloren e licencimit dhe vendimet e ERRU-se.

Administrimi i provave, dokumenteve dhe cdo gjë tjetër që ka të bëjë me çështjen, bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

### **Neni 10** **Dëgjimi i palëve të interesuara**

Në përfundim të procedurës hetimore, Komisioni thërret për të dëgjuar palën e interesuar që konsiderohet përgjegjëse për kryerjen e një kundërvajtjeje administrative mbi bazën e raportit dhe procesverbalit të paraqitur nga grupi i inspektimit.

Njoftimi zyrtar me shkrim, së bashku me një kopje të procesverbalit duhet t'i dërgohet subjektit të paktën 10 ditë punë më parë datës së caktuar për mbledhjen e Komisionit. (paralelisht do të përdoren njoftimi elektronik nëpërmjet emailit dhe nëpërmjet telefonit).

Në lajmërim tregohen vendi, data dhe ora e mbledhjes së komisionit, për shqyrtimin e kundërvajtjes në fjalë.

Komisioni dëgjon palët e interesuara për çështjen në fjalë. Palët e interesuara mund të shprehen me shkrim ose me gojë për ato çështje që përbëjnë objektin e procedimit.

Komisioni mund të procedojë në datën, vendin dhe orën e caktuar, edhe nëse pala e thirrur për të dhënë shpjegimet e saj nuk është paraqitur, me përjashtim të rastit kur palët paraqesin arsye përpara fillimit të seancës.

### **Neni 11** **Vendimi përfundimtar**

Në përfundim të procedurës hetimore, Komisioni merr vendim përfundimtar për kundërvajtjen. Në këtë vendim, Komisioni vendos në lidhje me gjithë çështjet e ngritura gjatë zhvillimit të procedimit dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.

### **Neni 12** **Përmbajtja e vendimit për kundërvajtjen**

Në vendimin për kundërvajtjen administrative jepen:

- a. organi që ka nxjerrë aktin;
- b. kundërvajtësi;
- c. shpjegimi i përmbledhur i fakteve dhe i provave, ku mbështetet vendimi;
- d. shkelja e kryer, duke referuar në dispozitën ligjore ku mbështetet vendimi;
- e. masat administrative përkatëse;
- f. cilësimi si titull ekzekutiv për masën e gjobës;
- g. hapat e tjerë që do të ndjekë Enti Rregullator;

**h.** të drejtën për ankim për procedurën e ndjekur.

Përveç të dhënave të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, në vendim mund të përfshihen edhe të dhëna të tjera, që Komisioni i sheh të arsyeshme.

### **Neni 13**

Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga Komisioni, përbën titull ekzekutiv.

Ky vendim i komunikohet zyrtarisht subjektit për ekzekutim vullnetar. Nëse subjekti nuk bën ekzekutimin e tij në mënyrë vullnetare, brenda afateve ligjore, ERRU i drejtohet për ekzekutimin e tij shërbimit përmbarimor shtetëror ose atij privat me marrveshje.

Vendimi për kundërvajtjen administrative botohet në fletoren zyrtare.

### **Neni 14**

ERRU ndjek vënien në ekzekutim të vendimit për kundërvajtjen administrative dhe plotëson dosjen për zyrën e shërbimit përmbarimor, e cila përmban:

- a.** kërkesën për ekzekutim;
- b.** titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar);
- c.** urdhërin e ekzekutimit nga Gjykata (origjinal);
- d.** pagesën e tarifës për vënien në ekzekutim;
- e.** autorizimin për personin që përfaqëson ERRU-në;

### **Neni 15**

Masa e gjobës së përcaktuar në vendimin për kundërvajtjen administrative derdhet në buxhetin e shtetit.

### **Neni 16**

Për sa nuk është parashikuar në këtë rregullore do të zbatohet Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, ligj nr.10 279, datë 20.5.2010 për “Kundërvajtjet administrative”, Kodi i Procedurave Civile dhe nr.8102 date 28.03.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar.

**Miraturar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU-së, nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2012**

MODEL

**PROCES – VERBAL**

I mbajtur sot më datë \_\_.\_\_.\_\_, në \_\_\_\_\_, shoqëria \_\_\_\_\_, nr.licence \_\_\_\_\_, datë \_\_.\_\_.\_\_, drejtues ligjor z.\_\_\_\_\_, drejtues teknik z.\_\_\_\_\_, adresa \_\_\_\_\_;

**Grupi i inspektimit i ERRU, i përbërë nga:**

Z/znj. \_\_\_\_\_;

**Shoqëria \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga:**

Z/znj. \_\_\_\_\_;

Nga verifikimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, dhe nga verifikimi i kushteve konkrete të ushtrimit të veprimtarisë, u konstatua:

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 8102, datë 28.3.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, mbahet ky procesverbal.

Procesverbali u mbajt në tre kopje, nje kopje lihet subjektit, nje kopje mbahet nga grupi i inspektimit, një kopje në protokollin e ERRU-së.

**Grupi inspektimit**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

**Shoqëria**

\_\_\_\_\_

**Përfaqësues**

\_\_\_\_\_

Emër, Mbiemër, Firmë

Nuk pranon të nënshkruaj \_\_\_\_\_